



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:102177

Datë: 28.12.2023

Numri i dokumentit: 05136369

Ep.nr.136/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbareme të kreditorit K "A", SH.A, rruga "Xh. S", pn, nga P, kundër debitorit A (B) R, nga fshati B, i Komunës së Pejës, me bazë juridike pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit afarist, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaremit Privat B .B, P.nr.I.br.114/22, i datës 25.03.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datë 28.12.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë në këtë çështje juridike përmbareme, e evidentuar me Epr.nr.136/2022, ndërmjet kreditorit K "A", SH.A dhe debitorit A (B) R, nga fshati B, i komunës së P.
- II. Pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale-Departamenti për Çështje Ekonomike, si gjykatë kompetente për trajtimin e lëndës në pikëpamje lëndore.

A r s y e t i m

Kreditori K "A", SH.A, me datë 25.03.2022, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbaremit ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e mbeturinave, për periudhën kohore nga data 01.08.2012 e deri më 28.02.2022, në shumën prej 963.73 euro.

Përmbaremi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin P.nr.I.br.114/22, i datës 25.03.2022, duke lejuar përmbaremin e propozuar.

Debitori A. R me datën 04.04.2022, ka parashtruar prapësim kundër urdhrin përmbarimor, duke e kundërshtuar gjendjes faktike sepse në bazë të faturave të kreditorit rezulton qartë se borxhi ka të bëjë për periudhën kohore prej vitit 2012 e deri në vitin 2022. Debitori konsideron se pagimi i borxhit në emër të kryerjes së shërbimeve nga kreditori është parashkruar në bazë të nenin 360 par.1 pika 1.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin dhe ta hedhë poshtë urdhrin përmbarimor.

Vlerësimi i kompetencës lëndore të gjykatës.

Gjykata pasi ka marrë në vlerësim lëndën përmbarimore, nga shkesat e lëndës bëhet e ditur se procedura përmbarimore, është iniciuar përmes propozimit për përmbarim të mbështetur në dokumentin e besueshëm-ekstraktin afarist kartelës së konsumatorit me numër 27276 dhe 20140019, në të cilin figuron si konsumator “V R” SH.P.K, me numër fiskal, në B, me pronar A (B) R. Poashtu në Marrëveshjen mbi Programimin e Borxhit me numër 601, të datës 10.02.2020, e bashkangjitur shkresave të lëndës figuron si palë kreditore K “A”, SH.A, dhe debitor V. Ri SH.P.K, me pronar A (B) R.

Andaj, gjykata sipas detyrës zyrtare duke vlerësuar kompetencën lëndore, ka ardhur në përfundim se lënda përmbarimore ndërmjet kreditorit K “A”, SH.A dhe debitorit A. R, si pronar i “V. R” SH.P.K, me numër fiskal, në B, nuk mund të gjykohet pranë Gjykatës Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshëm, për shkak të mungesës së kompetencës lëndore.

Në bazë të nenit 19 par.1 të LPK-së “*Secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdesët për kompetencën e vet lëndore*”, kurse në nenin 29 par.1 të LPK-së përcaktohet se “*Në procedurë kontestimore gjykatat gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së vet lëndore të caktuar me ligj*”.

Bazuar në nenin 13 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet kompetenca ekskluzive lëndore e Gjykatës Komerciale për trajtimin e kontesteve ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre dhe të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.

Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se në këtë çështje përmbarimore, në cilësinë e kreditorit është K “A”, SH.A, e cila është ndërmarrje publike, funksionimi i së cilës rregullohet në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ndërsa organizimi i saj afarist është shoqëri aksionare, në kuptim të nenit 4 të këtij ligji që përcaktohet se *“Të gjitha NP do të organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare”*.

Në anën tjetër, pala debitore A.R si pronar i “V.R” SH.P.K, me numër fiskal, bazuar edhe në të dhënat e ARBK-së, është subjekt afarist i cili është i regjistruar në ARBK, si shoqëri tregtare në formën e organizimit të shoqërisë më përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K). Kurse çështja juridike ndërmjet palëve në këtë procedurë përmbarimore, lidhet me marrëdhëniet juridike civile që kanë të bëjnë me dhënien e shërbimeve dhe kryerjen e pagesave. Andaj, sipas vlerësimit të gjykatës, kompetente për të vendosur mes këtyre dy subjekteve juridike është Gjykata Komerciale-Departamenti për Çështje Ekonomike.

Nga të lartcekurat, rezulton se kjo gjykatë është jo kompetente për vendosjen lidhur me prapësimin e debitorit dhe për këtë arsyeje, duke u bazuar nenin 19 par.1, 29 par.1 të LPK-së, dhe nenin 13 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:102177

Ep.nr.136/2022, me datë 28.12.2023

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 15 ditësh
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes Gjykatës
Themelore në Pejë.